

Mekanizmat e Kontrollit të Ndërsjelltë: Bashkëpunëtorët Paralelë dhe Logjika Operative e Sigurimit të Shtetit (1945–1991)

Prof. as. dr. Artan Puto

Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimise Kulturore

Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë (UT)

Bio

Artan Puto- Pedagog pranë Departamentit të Arkeologjisë dhe Trashëgimise Kulturore, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, UT. Ligjeron lëndët Historia e Shqipërisë, Qytetërimi Shqiptar dhe Administrimi i Trashëgimise Kulturore. Ka përvojë të gjerë akademike, kërkimore dhe institucionale. Është angazhuar në projekte strategjike të Ministrisë së Kulturës, si anëtar i grupit të punës për rikonceptimin e Muzeut Historik Kombëtar (që nga viti 2018) dhe për realizimin e projektit muzeal “Shtëpia me Gjethë” (2015–2017). Përvoja e tij përfshin edhe angazhime kërkimore ndërkombëtare, përfshirë pjesëmarrjen në projektin “We, the People: National Ideologies in South East Europe at the Turn of the XIX Century” (2004–2005), si dhe aktivitet si visiting professor në fushën e teorive të nacionalizmit. Ndër botimet më të rëndësishme të tij janë: “The Cult of Enver Hoxha”, në *The Leader Cult in Communist Dictatorships: Stalin and the Eastern Bloc*, Macmillan, 2004, “Pushtimi sovjetik i Çekosllovakisë në vitin 1968 dhe qëndrimi i udhëheqjes komuniste shqiptare ndaj “Pranverës së Pragës”, në *Njëqind vjet marrëdhënie shqiptaro-çekosllovaqe*, Karolinum, 2022, f. 73–94.

Abstrakt

Studimi fokusohet në analizën e strukturave, mekanizmave dhe dinamikave të rrjetit të bashkëpunëtorëve të ish-Sigurimit të Shtetit në Shqipëri gjatë periudhës 1945–1991, me theks të veçantë mbi proceset e rekrutimit, organizimit dhe funksionimit operacional. Ai shqyrton evolucionin e praktikave operative në lidhje me ndryshimet institucionale dhe politike të regjimit, duke vlerësuar ndikimin e udhëzimeve normative, manualeve procedurale, kartotekave dhe platformave të punës së Byrosë Politike në orientimin strategjik të aparatit të sigurisë.

Analiza mbështetet në studimin krahasues të dosjeve model të bashkëpunëtorëve dhe bashkëpunëtorëve paralelë, pa përfshirjen e të dhënave personale, me synim evidentimin e transformimeve në kriteret e përzgjedhjes, metodologjitë operative dhe mekanizmat e kontrollit.

Vëmendje e veçantë i kushtohet fenomenit të bashkëpunëtorëve paralelë dhe rolit të tyre në mekanizmat e kontrollit të ndërsjelltë, përmes të cilëve individët monitoronin veprimtarinë e njëri-tjetrit për të garantuar disiplinën, standardizimin dhe efikasitetin operacional. Studimi ofron një periodizim analitik të praktikave operative në vitet 1945, 1950, 1970, 1980 dhe 1990, duke i lidhur ato me zhvillimet politike dhe institucionale të brendshme të regjimit.

Në përfundim, artikulli kontribuon në ndërtimin e një kuadri të qartë historik dhe institucional për një kuptim më të thelluar të funksionimit të ish-Sigurimit të Shtetit dhe të logjikës strukturore të rrjetit të tij të bashkëpunëtorëve.

Metodologjia e kërkimit bazohet në analizë arkivore cilësore, analizë përmbajtjeje, qasje krahasuese dhe analizë institucionale, të ndërthurura përmes verifikimit të ndërsjelltë të burimeve, me qëllim sigurimin e koherencës dhe qëndrueshmërisë analitike të rezultateve.

Fjalë kyçe: Sigurimi i Shtetit; bashkëpunëtorë; bashkëpunëtorë paralelë; rekrutim; mekanizma kontrolli; praktika operative; manuale procedurale; Shqipëri (1945–1991).